

JETESHKRIMI

Inxh. Dip. Gjejlane (Belegu) Hoxha, Arkitekt përgjegjës për konservim

E-mail: gjejlaneh@gmail.com

Me profesion inxhinierë është inxhinierë e arkitekturës dhe specialiste në fushën e konservimit të trashëgimisë ndërtimore. Shkollimin e mesëm dhe atë universitar e ka kryer në Prishtinë. Studimet Pasuniversitare i vijoi në Universitetin e Zagrebit, pranë Katedrës së Konservimit të Trashëgimisë Ndërtimore me seli në Split dhe pranë Qendrës Ndërkombëtare për Studim, Konservim dhe Restaurim të Pasurisë Kulturore (ICCROM) në Romë, ka përfunduar kursin specialistik ndërkombëtar për konservim të trashëgimisë ndërtimore. Pranë Akademive Shtetërore për Administrim Publik në Berlin dhe në Romë, ka kryer trajnime për administrim publik. Është njohëse e gjuhëve angleze, frënge dhe serbokroate.

Veprimtarinë në fushën e trashëgimisë kulturore e ushtron prej një periudhe 24 vjeçare, përkatësisht gjatë periudhës 1985-2009 ka qenë punonjëse në Institutin e Kosovës për Mbrojtje të Monumenteve në Prishtinë, duke veçuar periudhën e viteve 2000-2006, kur ishte themeluese dhe drejtuese e Divizionit të Trashëgimisë Kulturore pranë Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve të Republikës së Kosovës. Nga muaji janar 2010 është emëruar Udhëheqëse Ekzekutive e Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore me seli në Prishtinë, organ i krijuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Nga viti 1999 është anëtare e Kryesisë së Asociacionit të Arkitektëve të Kosovës.

Në cilësinë e arkitektit dhe specialistit në fushën e konservimit dhe me fokus në avancimin e gjendjes së trashëgimisë kulturore në Republikën e Kosovës, ka zhvilluar game të gjerë aktivitetesh me karakter vendor dhe ndërkombëtar. Aktivitetet ishin me përmbajtje komplekse dhe shumë disiplinare, gjithëherë me qasje bashkëkohore, ndër të cilat veçohen:

- identifikimi dhe dokumentimi i tërësive kulturore historike të dëmtuara gjatë luftës së fundit nga forcat serbe, të cilat materiale janë shfrytëzuan për kompletimin e ekspertizave ndërkombëtare si dhe kanë shërbyer si dëshmi për kompletimin e akuzës ndaj autoriteteve serbe në Tribunalin e Hagës për krime lufte.
- mbështetja e zhvillimit dhe themelimit të institucioneve të kulturës dhe të trashëgimisë kulturore;
- hartimi i Strategjisë Nacionale për Zhvillim të Kulturës dhe të Strategjisë Nacionale për Trashëgimi Kulturore;
- identifikimi dhe inventarizimi i trashëgimisë kulturore në territorin e Kosovës;
- krijimi i kuadrit Ligjor për trashëgimi kulturore;
- restaurimi i 30 monumenteve/tërësive kulturore historike të rrezikuara (kulla, xhami, mullinj, hamame, lokalitete arkeologjike, ansamble banimi tradicional etj);
- Hartimi i Studimeve dhe Planeve të Zhvillimit dhe Konservimit të Zonave Historike Tradicionale;
- ngritja dhe përmirësimi i kapaciteteve të kuadrit konservator/restaurator kosovar, pranë ekspertësh me përvojë ndërkombëtare; etj.

Në cilësinë e arkitektit dhe qytetarit të Republikës së Kosovës, konsiderohet eksperte dhe punonjëse dinamike, e përgjegjshme dhe me përgatitje specialistike të certifikuar në nivele vendor e ndërkombëtar. Puna e saj ka për qëllim zhvillimin dhe mbështetjen e programe me objektiva për ruajtjen dhe konservimin e trashëgimisë kulturore si komponent me attribute fisnike të mjedisit jetësor në dobi të zhvillimeve shoqërore, kulturore dhe ekonomike të Kosovës.